



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:181488

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05768754

KPPP.nr. 327/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Liridon” SH.P.K, dhe me nr. të biznesit 70378079 dhe me seli në Komunën e Rahovecit, fshati Dobidol-Lugmir, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përbarimit CP.nr. 01/2014 të datës 06.01.2014, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, jashtë seancës, me datë 03.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Liridon” SH.P.K, ashtu që Aktvendimi mbi lejimin e përbarimit CP.nr. 01/2014 i datës 06.01.2014, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, SHFUQIZOHET .

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë me datë 06.01.2014 ka lëshuar aktvendimin CP.nr. 01/2014 duke lejuar përbarimin mbi bazën e dokumentit Aktvendim nr. prot 3285 i datës 22.12.2012, me të cilin është detyruar debitori, që në emër të gjobës administrative, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,000.00 EUR.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me aktvendimin CP.nr. 2/2014 të datës 23.05.2015 ka pezulluar procedurën përbarimore për shkak të vdekjes së pronarit të debitorit Isuf Krasniqi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr. 1511/2015 të datës 21.07.2016 ka aprovuar ankesën e kreditorit duke anuluar aktvendimin CP.nr. 2/2014 të datës 23.05.2015 të marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje. Në arsyetimin e saj, gjykata ka theksuar se në rastin konkret, kemi të bëjmë me subjekt juridik në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, andaj nuk ka kushte për ndërprerjen e procedurës.

Pas kthimit të lëndës në rivendosje, prapësim ka parashtruar M.K., i cili në regjistrin publik të ARBK-së tanimë figuron si pronar i debitorit “Liridioni” Sh.P.K., dhe i cili ka kundërshtuar aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit duke theksuar se i njëjti është i versionit fotokopje, dhe nuk i përmban elementet e përcaktuara me LPP.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, në bazë të kompetencës lëndore, është transferuar për shqyrtim të mëtutjeshëm pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 22, paragrafi 1.2 të ligjit përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia)”*. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti Aktvendim nr. prot. 3285 i datës 22.12.2012 në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim është bashkangjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar..”*

Përkundër kësaj, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec si organ përmbarues në këtë çështje përmbarimore nuk ka evituar këto të meta në propozimin për përmbarim, obligim ky që del nga neni 38, par.2 të LPP-së me të cilin parashihet se “ *Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.* ”

Në këtë drejtim, referuar nenit 43, par.4 të LPP-së i cili përcakton se “*...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim*” Gjykata gjeti se aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit CP.nr. 01/2014 i datës 06.01.2014 është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit, pasi që propozimi për përmbarim bazohet në një dokument kopje.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 327/24, datë 03.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.